

LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 8: Mars - Qershor 2021



Të nderuar prindër,

Fundi i këtij viti shkollor po afron dhe ne, si Shkolla NEHEMIA, jemi mirënjohës për ecurinë dhe rezultatet e arritura, veçanërisht në kushtet në të cilat ndodhemi.

Me shumë përshtatje organizative, ne arritëm t'i kishim nxënësit në klasë për zhvillimin e mësimin; orët mësimore u kryen të plota; ofruam shërbimin e mensës dhe madje edhe shumë programe të tjera jashtëshkollore.

Ne investuam një shumë të konsiderueshme në pajisjen e klasave me ekran, kamera, kompjutera dhe sigurisht edhe me linjë interneti.

Në këtë mënyrë, nxënësit, të cilët për arsye të ndryshme nuk kishin

mundësi për të qenë fizikisht në klasë, e ndoqën mësimin që nga shtëpia. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në mësimdhënie do të vazhdojë të jetë pjesë e mësimdhënies tek ne, si pjesë e domosdoshme e epokës ku jetojmë. Ky vit shkollor ishte sfidues. Në fakt, një vit shkollor është gjithmonë sfidues dhe kush është i angazhuar në fushën e arsimit, e di këtë edhe nga përvoja.

Por ne jemi mirënjohës që pavarësisht shumë të panjohurave në fillim të vitit shkollor, ne mund të themi që ia kemi dalë mbanë. Falënderojmë të gjithë stafin mësimor për punën e tyre plot pasion dhe angazhim, si edhe bashkëpunëtorët tanë të projekteve të shërbimit dhe mirëmbajtjes, të projektit të administratës dhe

ju falënderojmë ju, prindër, për mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në takimet me prindërit, si edhe për përgjigjet tuaja nëpër anketimet që ju kemi dërguar. Për ne ato janë një indikator i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe shërbimeve tona.

Duke shpresuar për një vit të ardhshëm shkollor sa më të suksesshëm, ju urojmë mbi të gjitha shëndet.

Me respekt,
Elona Rira
Drejtoresh e Shkollës NEHEMIA

elona.rira@ng.team

AKTIVITETE

Kopshti

Fëmijët e kopshtit kanë qenë shumë të angazhuar me aktivitete të ndryshme. Ata mësojnë çdo ditë gjëra të reja, duke luajtur dhe duke u argëtuar. Për të përmendur vetëm disa prej aktiviteteve të tyre gjatë këtyre muajve:

- Fëmijët janë njohur me natyrën, bimët, kafshët; kanë mësuar çfarë marrim nga bimët dhe pse ato janë një pjesë e rëndësishme në ushqyerjen tonë.
- Ata përforcuan njohjen mbi shqisat, organet dhe funksionet e tyre. Kanë emërtuar lodrat në kopsht dhe i kanë përshkruar sipas figurave gjeometrike.
- Janë zhvilluar disa veprimtari të ndryshme me tema si: Dashuria për profesione të ndryshme; si të kujdesemi për dhëmbët; dita e balonave; dita e tokës; respekti për njerëzit që kanë më shumë nevojë; vizitë nga infermierja, e cila i njohu fëmijët me disa prej veglave që përdor një mjek, apo që përdoren për dhënien e ndihmës së shpejtë; aktiviteti "Unë kam të drejtë të ...", ku fëmijët u njohën me disa të drejta të tyre, si.p.sh. që të mjekohen, të luajnë, të shkollohen, të ushqehen, të kenë një emër, etj., gjithmonë nëpërmjet lojërave praktike dhe një filmi vizatimor për fëmijë, i shfaqur në ambientet e kopshtit.

Arsimi fillor

Përgëzojmë fëmijët e klasës së pestë, bashkë me mësuesen e tyre, për përfundimin e këtij cikli të parë shkollor dhe ju urojmë atyre suksese për klasat e mëtejshme.

Edhe fëmijët e ciklit fillor, krahas procesit mësimor, kanë zhvilluar një sërë aktivitete të ndryshme. Ata kanë festuar ditën e tokës; kanë zhvilluar ndeshje me shkollën Amaro Tan; kanë organizuar me iniciativën e tyre ditën e këpucës ndryshe; apo të flokëve ndryshe; lojëra popullore; aktivitete në natyrë; vizitë në Drilon; te sera e luleve; në Voskopojë; në Lin; vizitë në Muzeun Historik të Pogradecit etj.

Kurorëzimi i këtyre veprimtarive ishte 1 Qershori, dita e fëmijëve, në të cilën jo vetëm që u organizua dita e Biznesmenëve të Vegjël, por u organizua edhe një ekspozitë nga fëmijët e ciklit fillor me temë "Krijuesit e vegjël".

Arsimi i mesëm i ulët dhe i lartë

I përgëzojmë nxënësit dhe mësuesit për punën e tyre gjatë këtij viti shkollor, ku megjithë vështirësitë e mësimdhënies në distancë apo online, kanë qenë të angazhuar dhe kanë dhënë më të mirën e tyre. Disa nga këto fryte i shikojmë edhe nëpër konkurse të ndryshme jashtëshkollore, siç është konkursi i matematikës Kangaroo, ku kishim fitues 3 nxënës nga klasa e VIII-të, 4 nga klasa e VII-të, 3 nga klasa e VA dhe 3 nga klasa e VIB.



Gjatë muajve maj-qershor nxënësit kanë qenë në ethet e testimave të tre-mujorit dhe të drejtorisë. Veçanërisht maturantët u janë nënshtruar testeve provë të maturës. Lu urojmë shumë suksese në provimet e tyre të maturës, si edhe në studimet e tyre të mëtejshme.

Nxënësit, gjithashtu, kanë përgatitur projekte lëndore dhe ndër-lëndore të ndryshme, të cilat i kanë prezantuar përpara klasës dhe nxënësve të tjerë.

NJOFTIME:

Dëftesat për klasat I–XI do të shpërndahen në datë 30 qershor 2021. Po në këtë ditë do t'ju jepen edhe kontratat për vitin e ardhshëm shkollor, bashkë me formularët e pagesës dhe listën e pikëve NCTS. Ne si shkollë, për arsye organizimi, presim nga ju që ta firmosni dhe dorëzoni kontratën po në këtë ditë. Në çdo rast, afati i fundit i dorëzimit të kontratës është data 15 gusht.

Viti shkollor 2021-2022 fillon në datën 7 shtator 2021.

Për të gjithë të interesuarit që duan të aplikojnë për regjistrimin e fëmijës së tyre tek Shkolla NEHEMIA për vitin shkollor 2021-2022, njoftojmë se regjistrimet vazhdojnë dhe mbyllen në datën 30 korrik 2021.

Nxtoni, pra, të regjistroni fëmijën tuaj në klasë të parë, në klasë të dhjetë apo në klasat e tjera.

Ju mund ta bëni aplikimin në formë elektronike në faqen zyrtare të Shkollës NEHEMIA:


www.nehemiah-gateway.al/al/nehemiah-school/

Regjistrime ose të paraqiteni personalisht tek sekretaria e shkollës nga e hëna në të premtën, në orarin 08:00–16:00.

Na ndiqni në facebook:

www.facebook.com/NehemiahGateway

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA
Nehemia 7304 Buçimas,
Pogradec Albania
Tel.: +355 83 600 403
Fax: +355 83 600 405
shkolla-nehemia@ng.team

Projekti jashtëkurrikular Royal Rangers – Nga Anila Sinani

Gjatë gjithë vitit shkollor pyetjet që dëgjoj shpesh janë: Mësuese kur do të fillojë kampi? A do kemi një kamp në natyrë këtë vit? A mund të shkojmë ekskursion diku? A mund të marrim pjesë në një kamp ndërkombëtar? Kampet dhe aktivitetet ditore ata i lidhin me aventurën, gallatën, sfidën, kënaqësinë, etj. Sipas psikologëve aktivitetet janë të rëndësishme për një rritje të shëndetshme të fëmijëve dhe të rinjve. Fëmijët dhe të rinjtë në ditët e sotme kanë nevojë për aktivitete, ku ata mund të sfidohen dhe forcohen nga ana fizike, intelektuale, shoqërore dhe shpirtërore. Disa nga aktivitetet që ne organizojmë në programin e Royal Rangers janë: ekskursion me ecje; shëtitje me biçikleta; kamp njëditor me fjetje; kamp me çadra në natyrë; kampionat futboll; lojëra olimpikë; kamp fisi; kamp kombëtar; kamp ndërkombëtar; etj. Si Drejtuesja e Royal Rangers kam vënë re se në aktivitete, pjesëmarrësit jo vetëm kënaqen, por ata forcojnë miqësitë, njohin miq të rinj dhe kultura të reja, mësojnë të mbajnë përgjegjësi, mësojnë të kujdesen për veten dhe të tjerët, zhvillojnë aftësi lidhësi, zhvillojnë ndjenjën e vetësigurisë dhe imazhit të vetes, si dhe mësojnë të praktikojnë gjithçka që ata dinë dhe që ne iu mësojmë në programin e Royal Rangers. Disa nga trajnimet që ne kemi trajtuar këtë vit kanë përfshirë: mbrojtjen e natyrës; dhënien e ndihmës së parë; ndezjen e zjarrit; ndërtimin e çadrave; si të kujdesemi për fizikun; etj. Sigurisht që këto trajnime janë shoqëruar edhe me tema si miqësi e fortë, falja, bindja ndaj autoriteteve, mbajtja e përgjegjësisë në shtëpi, etj.

Lista e aktiviteteve se çfarë mund të organizojmë me fëmijët dhe të rinjtë është vërtet e gjatë, por fatkeqësisht këtë vit pandemia na ka kufizuar deri diku.

Gjatë vitit shkollor 2020–2021 janë organizuar 7 ekskursione në natyrë, 1 kamp disa ditor me çadra në Durrës, 1 kamp në Peshkëpi dhe është duke u organizuar kampi ditor, i cili do të zhvillohet në fund të muajit qershor. Sigurisht që në të gjitha këto aktivitete, ne kemi patur ndihmën e prindërve, prandaj dua t'ju falënderoj përzemësisht që i regjistroni fëmijët në programin e Royal Rangers, që na besoni edukimin e tyre si dhe që jeni të papërtuar të na ndihmoni në çdo aktivitet që zhvillojmë. Këto janë disa momente nga aktivitetet që kemi organizuar me fëmijët dhe adoleshentët këtë vit.

Anila Sinani

